



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, Trupi Gjykses më 2 shtator lëshoi një urdhër të mëtejshëm për planifikimin e paraqitjes së provave prej Mbrojtjes. Trupi Gjykses caktoi ditën e premte, 14 nëntor, si datën e synuar për përfundimin e provave të Mbrojtjes, ose një javë pas përfundimit të dëshmisë së dëshmitarit të fundit, cilado të jetë më herët. Trupi Gjykses theksoi se kjo datë është thjesht vlerësim i përafërt i Trupit Gjykses për kohëzgjatjen e provave të Mbrojtjes dhe mund të afrohet apo shtyhet, sipas nevojës.

Trupi Gjykses theksoi se ZPS-ja mund të dëshirojë të paraqesë kundërprova ndaj provave të Mbrojtjes dhe se Mbrojtja mund të dojë të përgjigjet në këtë rast. Pa paragjykuar këtë mundësi, Trupi Gjykses informoi palët dhe pjesëmarrësit se duhet të përgatiten të dorëzojnë dosjet përfundimtare dhe deklaratën mbi pasojat e veprave penale të pretenduara ndaj viktimave pjesëmarrëse në proces para pushimit dimëror të Gjykatës, më 22 dhjetor 2025. Trupi Gjykses shtoi se do të caktojë datën përfundimtare lidhur me këtë aspekt pasi Mbrojtja të ketë avancuar më shumë me paraqitjen e provave dhe pasi Trupi Gjykses të ketë dëgjuar palët lidhur me këtë pikë.

Trupi Gjykses rikujton se Mbrojtja e Thaçit parashtroi se, me përjashtim të një dëshmitari, të gjithë dëshmitarët e tjerë do të japin dëshmi në sallën e gjyqit, ose si dëshmitarë gojorë, ose do të jenë të pranishëm për pyetje nga pala kundërshtare pasi të jenë dorëzuar dëshmitë e tyre me shkrim. Mbrojtja e Krasniqit parashtroi se dy nga dëshmitarët e saj do të jenë të pranishëm në sallën e gjyqit për t'u pyetur nga pala kundërshtare dhe tri dëshmi do të dorëzohen vetëm me shkrim, në varësi të miratimit prej Trupit Gjykses.

Trupi Gjykses caktoi afatin për dorëzimin në mënyrë progresive të të gjitha provave që nuk kanë lidhje tematike me dëshmitë e dëshmitarëve, që duhet të përfundojë jo më vonë se një javë pas dëshmisë së dëshmitarit të fundit të ekipit përkatës të Mbrojtjes.

Seanca e ardhshme në këtë çështje është fillimi i paraqitjes së provave të Mbrojtjes, që është caktuar për të hënë, 15 shtator, në orën 9 paradite. Për këtë seancë nevojitet regjistrim paraprak. Gazetarët që dëshirojnë të ndjekin seancën nga galeria publike në Hagë, janë të lutur të njoftojnë nëse kanë nevojë t'u rezervohet një vend në qendrën për median e Dhomave të Specializuara.

Në çështjen *Hashim Thaçi, Bashkim Smakaj, Fadil Fazliu, Isni Kilaj dhe Hajredin Kuçi*, Paneli i Apelit më 1 shtator rrëzoi në tërësi apelin e Isni Kilajt kundër vendimit të Gjykatës së Procedurës Paraprake për vazhdimin e paraburgimit të tij. Paneli i Apelit u bind se në vendimin e saj, Gjykatësja e Procedurës Paraprake kishte zbatuar standardin e saktë, në pajtim me praktikën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i Apelit nuk konstatoi gabim në faktin se Gjykatësja e Procedurës Paraprake e mbështeti vendimin e saj në faktorë si: natyra e rëndë e veprës penale për të cilën akuzohet z. Kilaj; gatishmëria e treguar prej tij për të shkelur urdhra të Gjykatës dhe për të ndërhyrë në proces; qasja e tij në informacion lidhur me





dëshmitarë të cenueshëm dhe atmosfera e frikës dhe frikësimit ndaj dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm të Dhomave të Specializuara. Duke rikujtuar se Gjykatësja e Procedurës Paraprake e peshoi proporcionalitetin e paraburgimit të z. Kilaj kundrejt disa faktorëve, Paneli i Apelit u bind se ajo e mori parasysh siç duhet sasinë e kohës që ka kaluar ai në paraburgim në pritje të gjykimit, kur vlerësoi se vazhdimi i paraburgimit mbetet proporcional në këtë fazë.

Më 1 shtator, Dhoma e Apelit miratoi pjesërisht kërkesën e Salih Mustafës për të zgjatur afatin e z. Mustafa për dorëzimin e apelit të tij kundër vendimit të Gjykatës të Vetëm në lidhje me caktimin e kamatës prej 8% në vit mbi shumën e zhdëmtimeve që nuk është paguar ende.

Paneli vuri në dukje se kërkesa u dorëzua disa ditë pas afatit. Sidoqoftë, për të qenë i drejtë me z. Mustafa, Paneli, bëri përjashtim dhe e shqyrtoi kërkesën dhe konstatoi se ai kishte paraqitur arsye të vlefshme, duke pasur parasysh rëndësinë dhe risinë e këtij aspekti. Paneli u shpreh se është në interes të drejtësisë që palët të dorëzojnë parashtrime të mirëfillta dhe vlerësoi se shqyrtimi i këtyre pikave do të shërbejë për të garantuar drejtësinë procedurale dhe për të respektuar të drejtat dhe interesat e të dyjave palëve, të viktimave dhe të z. Mustafa. Për këtë arsye, Paneli i Apelit zgjati afatin për dorëzimin e apelit deri në 8 shtator.

